



Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti IV, nr. 13, janar-mars 2024

**Krishti u ringjall!
Me të vërtetë u ringjall,
aleluja!**



Misioni Katolik Shqiptar
Katholische Albanische Mission

LUZERN

faqe

REVISTË INFORMATIVE, KULTURORE
DHE SHPIRTËRORE E MISIONIT KATOLIK
SHQIPTAR NË LUZERN



SELIA E REVISTËS

Rodteggstrasse 6, CH-6005 Luzern
St. Michael



Tel: +41 41 250 52 60



anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch
albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch
ukas_cr@hotmail.com



<https://www.misioni-lu.ch/>



[https://www.facebook.com/ Misioni Katolik
Shqiptar - Luzern](https://www.facebook.com/Misioni%20Katolik%20Shqiptar%20-%20Luzern)



TË NDIHMOJMË REVISTËN

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3
Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 |
6005 Luzern

REDAKSIA

Dr. Don Anton Uka – kryeredaktor
Motër Vida Ademi – koordinuese
Veneranda Qerimi – redaktore e teksteve
Mirlinda Dushi Berisha – përgjegjëse për
intervista
Gjane Simoni – asistente
Motër Mrika Sabedini – asistente

6 **AKTIVITETET E MISIONIT**
Mbledhja me anëtarët e Korit

10 **AKTIVITETET E MISIONIT**
Takimi me Këshillin e Misionit

12–13 **AKTIVITETET E MISIONIT**
Ecuria e ansamblit “Shqiponja”

16 **AKTIVITETET E MISIONIT**
Bekimi i familjeve

18–19 **AKTUALITET**
Testoje njohurinë tënde mbi Pashkët

20–21 **PËRSHPIRTËRI**
Zoja e Lurdit – histori dhe porosi

22–23 **PËRSHPIRTËRI**
Valentinstags: Der Tag der Liebenden

24–26 **PËRSHPIRTËRI**
So beichte ich richtig!

28 **PSIKOLOGJI**
Të pushtuar nga inati

32-33 **KULTURË**
Vlerësim mbi librin “2000 vjet Krishterim te
Shqiptarët”

34–35 **AGJENDA**
Agjenda për muajt e ardhshëm

Krishti u ringjall! Me të vërtetë u ringjall, aleluja!

Të dashur lexues, koha që po përjetojmë, për shkak të angazhimeve dhe punëve të shumta, të jep ndjesinë se po kalon aq shpejt sa edhe festimi i festave më të rëndësishme rrezikon të bëhet rutinë si shumë të tjera dhe kështu të humbasë kuptimin e tij. Festa është festë pikërisht sepse është dhe duhet të jetë ndryshe nga ditët dhe momentet e tjera të jetës, ndryshe nuk mund të përkufizohet si e tillë. Kështu që shpresoj që të dimë të ndalemi dhe të festojmë me qetësi dhe kështu të rizbulojmë kuptimin dhe gëzimin e festës dhe jetës.

Tani që jemi gati të kremtojmë festën e Pashkëve, jemi të thirrur të mendojmë se kjo festë na kujton kalimin nga i ftohti i dimrit në ngrohtësinë e ditëve të pranverës dhe verës; të mendojmë për kalimin e popullit të zgjedhur nga skllavëria në lirinë e Tokës së Premtuar. Mbi të gjitha të mendojmë për kalimin e Jezusit nga vdekja në ringjallje. Pa harruar se të gjitha këto kalime përmbajnë një shpresë të madhe që edhe sot ka fuqinë të mbushë zemrën dhe mendjen e besimtarit me gëzim dhe dashuri të madhe për ta ndihmuar atë të kalojë nga errësira në dritë, nga urrejtja në falje, nga një jetë mëkatore në jetën e gëzueshme të hirit të Zotit.

Sot ka shumë njerëz që kanë nevojë dhe e ndjejnë në zemër se duhet ta bëjnë këtë kalim të rëndësishëm jetësor. Por disa kanë frikë, të tjerëve u mungon besimi, të tjerëve u mungon motivimi, ka nga ata që ndihen të braktisur dhe të vetmuar, të tjerë të humbur në gjërat dhe problemet e jetës. Prandaj, njeriu i sotëm ka nevojë për njerëz që e kanë takuar vërtetë Jezusin e ringjallur në përvojën e tyre shpirtërore dhe falë këtij takimi dinë të bëhen të afërm dhe të dashur ndaj të gjithë atyre që kanë nevojë të dalin nga varri i vuajtjes dhe mëkatit në të cilin gjenden.

Përjetimi i Pashkëve në këtë mënyrë do të ishte festa më e bukur sepse kështu do të kuptonim se falë fuqisë së Krishtit edhe ne mund dhe duhet të ringjallemi sërish në një marrëdhënie më të mirë me Zotin, me të tjerët, por edhe me vetveten. Të jetosh me këtë shpresë dhe me këtë besim te Jezusi i ringjallur do të thotë të kuptosh dhe njëkohësisht të besosh se kryqi, si sinonim i vuajtjes njerëzore, nuk është tjetër veçse një mjet për të kaluar nga vuajtja në lumturi.

"Lajmi i mirë se Jezusi u ringjall nga të vdekurit do të thotë për ne se dashuria për Zotin është më e fortë se e keqja dhe vetë vdekja; do të thotë se dashuria e Hyjit mund të transformojë jetën tonë, të bëjë të lulëzojnë ato fusha të shkreta që ekzistojnë në zemrat tona", thoshte Papa Françesku.

Nëpërmjet këtij mesazhi të festës së Pashkëve, shpresoj dhe i lutem Zotit që në të gjitha familjet tona, veçanërisht në ato ku ka vuajtje, sëmundje dhe probleme, të rikthehet festa dhe gëzimi dhe të bashkuar të festojmë ringjalljen e Jezusit.

Gëzuar e me shëndet Pashkët!

Don Antoni



KRISHTLINDJA NË MISIONIN TONË

(Foto: Nue Tuqi)

Krishtlindja në Misionin tonë është kremtuar në mënyrë solemne. Natën e Krishtlindjes janë kremtuar katër Meshë të shenjta: në Luzern, Getnau, Emmenbrücke dhe në Inwil. Kurse ditën e Krishtlindjes Mesha shenje është kremtuar në Goldau dhe në Sursee.

Përveç don Antonit, misionarit tonë, për të na ndihmuar i pranishëm nga Kosova ishte edhe don Shtjefën Dodes, drejtor i Radio Marisë së Kosovës. Në të gjitha vendet ku është



(Foto: Nue Tuqi)

kremtuar Mesha shenjtë, kishat kanë qenë të mbushura me besimtarë të moshave të ndryshme, me një atmosferë të përshpirtshme dhe të gëzuar duke e lavdëruar Zotin me këngë të bukura të krishtlindjes. Kjo festë kaloi shumë bukur duke kremtuar lindjen e Birit të Zotit, që për ne është bërë njeri.

Krishtlindja është festa e lindjes së Zotit i bërë njeri. Është festë gëzimi për të gjithë të krishterët, të cilët e kremtojnë në mënyrë solemne, e kjo është vërejtur edhe tek besimtarët tanë – gëzimi dhe lumturia, urimi i përzemërt i ndërsjellët është bashkëndarë kudo.



(Foto: Nue Tuqi)

Shkruan: Redaksia



Pas kremtimit liturgjik të festës së Krishtlindjes, në një atmosferë miqësore dhe shumë gazmore për lindjen e Birit të Zotit, në të njëjtën ditë, në mbrëmje, u festua festa tradicionale familjare. Rreth 300 veta familjarë e të tjerë, duke shfrytëzuar hapësirën e madhe që ka qendra italiane “Papa Giovanni” në Emmen.

Don Anton Uka përgjegjësi i misionit i përshëndeti pranishmit në fillim të festës, duke uruar festën e Krishtlindjes dhe mirëseardhjen, duke ja lenë rendin muzikës me këngë të bukura shqiptare që na i dhuruan Vëllezërit Aliu,

të cilat na shoqëruan gjatë gjithë mbrëmjes. Porsa filloi muzika, të pranishmit menjëherë filluan vallëzimin me valle të ndryshme kombëtare.

Për përgatitjen e sallës, pritjen, drejtimin e mysafirëve në vendet e tyre janë kujdesur të rinjtë e Misionit në mënyrë vullnetare, duke bërë një punë shumë të mirë dhe të organizuar, saqë gjithçka ka shkuar sipas planit të paraparë. Më pas ka vazhduar darka për të gjithë, e përgatitur me shumë shije nga Kastriot dhe Vera Frrokaj, ndërsa shërbimin në tavolina gjithashtu e kanë bërë të rinjtë e Ansambllit “Shqiponja” nga Misioni ynë në Luzern.

Faleminderit Zotit për të gjitha të mirat që na jep, falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit, grupin muzikor Vëllezërit Aliu, për atmosferën e mrekullueshme që na dhuroi, stafin e kuzhinës Kastriot dhe Vera Frrokaj, për darkën e shijshme, si edhe të rinjtë dhe të rejtat e Ansambllit “Shqiponja” për shërbimin dhe organizimin dinjitoz.



(Foto: Don Anton Uka)

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: don Anton Uka)

Më 26 janar 2024 Kori i Misionit pati mbledhjen e radhës. Mbledhja u organizua nga Valentina Pernrecaj dhe Flora Rosaj, kryetare të korit së bashku me motër Mrika Sabedini, drejtuese e korit. Në këtë takim ishin të pranishëm thuajse të gjithë anëtarët por edhe udhëheqësi i Misionit don Anton Uka.

Mbledhja është zhvilluar të premten pas provave të rregullta të korit në Qendrën e Misionit tonë në Luzern. Pas lutjes së shkurtër dhe përshëndetjes nga ana e Valentina Pernrecaj, është lexuar protokoli i takimit të fundit dhe

më pas është vazhduar me shqyrtimin e pikave të parapara për këtë mbledhje.

Në këtë mbledhje janë shqyrtuar shumë gjëra në lidhje me korin e Misionit tonë lidhur me bashkëpunimin, angazhimin e tyre në Mision dhe por edhe lidhur me kremtimet e ndryshme kishtare, duke përfshirë edhe festat personale sikurse janë jubiletë e anëtarëve të korit, ose festime të tjera të anëtarëve. Në mbledhje ishin të pranishëm gjithsej 28 anëtarë të korit. Më pas është vazhduar me një darkë të shijshme, e ofruar nga Emanuel dhe Antoneta Marku dhe Maria Koshi.

Kori i Misionit ka rëndësi të madhe për Misionin tonë, në veçanti në ndihmesën që jep gjatë kremtimit të Meshës së shenjte. Ky grup i korit merr pjesë rregullisht në kremtimin e meshës së shenjte në Sursee, Emmenbrücke dhe në Luzern. Më këndimin e tyre të harmonizuar zbukurojnë Meshën shenjte dhe lëvdojnë Zotin.

Këndimi në liturgji është shumë më rëndësi sa që edhe Shën Augustini e konsideron si lutje të dyfishtë.



(Foto: Kolë Milici)



FESTA E ZOJËS SË LURDIT

(Foto: Nive Tuzaj)

Në Misionin tonë festa e Zojës së Lurdit është kremtuar solemnisht. Në vigjilien e festës, të shtunën në mbrëmje në kishën e famullisë St. Michael në Luzern kemi kremtuar këtë festë aq të dashur për besimtarët tanë. Shumica prej besimtarëve kanë shtegtuar edhe në Lurd, vendi i shfaqjes së Zojës Shën Bernradetës dhe dy fëmijëve të tjerë, që kanë qenë duke i ruajtur delet. Kështu

festa e Zojës së Lurdit është bërë edhe më e dashur dhe më e pranueshme për të gjithë të pranishmit.

Kremtimit i ka paraprirë lutjen e rruzares së shenjtë të Zojës dhe më pas don Anton Uka ka kremtuar Meshën shenjte, i cili gjatë predikimit të tij është përqendruar në shpjegimin e procesionit. Procesioni në këtë festë të Zojës bëhet rregullisht në të gjitha vendet në kishën katolike ku festohet. Më pas don Antoni ka ndarë sakramentin e të sëmurve – vajimin për të gjithë të pranishmit që kanë dëshiruar ta marrin atë. Më pas ka vazhduar procesioni jashtë kishës duke kaluar rrugën jashtë oborrit me qirinj të ndezur, ku më pas të gjithë janë kthyer përsëri në kishë, dhe të gjithë së bashku kemi lutur lutjen e Zojës Lurde.

Pjesëmarrja e besimtarëve ishte e madhe, e në fund të gjithë kanë qenë të ftuar në Apero, e dhuruar nga familjet e famullisë së Stubllës së Epërme, të cilët këtë festë e festojnë solemnisht në famullinë e tyre. Falënderojmë Zotin, Zojën e Lurdit dhe të gjithë bamirësit për kontributin që japin në Misionin tonë.



(Foto: Samuel Bekaj)

Shkruan: m. Vida Ademi



TAKIMI ME KORIN E MISIONIT NË WILLISAU

(Foto: Nue Tuqi)

Më 11 shkurt gjatë Meshës shenjte të kremtuar nga don Antoni, u pagëzuan tre persona: një nënë me dy djemtë e saj. Po ashtu edhe në Willisau ishte një pagëzim i një fëmije të vogël.

Ndërsa pas Meshës shenjte në Willisau, kori i Willisaut me disa anëtarë të tjerë familjar dhe të afërt, bashkë me don Antonin dhe motrat kemi qëndruar së bashku në qendrën e kishës, duke u shoqëruar me njëri-tjetrin dhe duke shijuar ushqime të shijshme, të sjella nga anëtarët e korit të Willisaut. Ishte një mbrëmje shumë e këndshme, ku të gjithë së bashku

jemi ndjerë të bashkuar, duke shkëmbyer biseda dhe shaka me njëri-tjetrin. Edhe gëzimi e të qeshurat nuk munguan në të gjithë të pranishmit.

Kori kishtar zbukuron dhe pasuron liturgjinë. Kënga në Meshën shenjte është lavdërim dhe falënderim për shkak të veprave të mëdha të Zotit.

Shkruan: Redaksia



(Foto: don Anton Uka)



(Foto: Nue Tuqi)



E MËRKURA E PËRHIME

(Foto: Nue Tuqi)

Më 14 shkurt u fillua koha e shenjtë e kreshmëve me meshën e shenjtë në Misionin tonë në St. Michael, në Luzern. Para Meshës shenjte është lutur rruzarja e Zojës, sikurse lutet zakonisht në shumë kisha para çdo Meshe shenjte.

Kreshmët janë kohë kur gjatë katërdhjetë ditëve besimtarët përgatiten për festën e Pashkëve – ringjalljen e Zotit tonë Jezu Krishtit, e krenrtja më e madhe në Kishën katolike. Të Mërkurën e përhimë besimtarët përhihen më hi, simbol që tregon se po fillon koha e kreshmëve. Po fillon një kohë serioze e pendimit, sakrificës, angazhimit më të madh se zakonisht për t'ju ndihmuar nevojtarëve në mënyra të ndryshme, për të vizituar të vetmuarit, të lënit

pas dore e në veçanti për t'ju kushtuar më tepër lutjes, leximit dhe meditimit të fjalës së Zotit. Të Mërkurën e përhimë dhe të Premten e Madhe Kisha shenjte kërkon prej besimtarëve të saj njinim dhe agjërim, e kjo domethënë se prej moshës 18-të deri 60-të vjeç këshillohet të mbahet të njinimin dhe agjërimin, duke përjash-tuar të sëmurët.

Agjërim do të thotë se një herë në ditë mund të marrim ushqim të mjaftueshëm, ndërsa në vaktet e tjera shumë pak ose aspak ushqim. Ndërsa gjatë ditëve të premtë nuk është e lejuar të hahet mish dhe me rëndësi gjatë kohës së kreshmëve është të bëjmë vepra të mira. Kisha shpreson se besimtarët e saj do ta kuptojnë dhe pranojnë mësimin dhe propozimin e Kishës. Të gjithë njerëzit janë të ftuar që gjatë kohës së kreshme të bëjmë diçka – si për shembull të largojmë ndonjë ves personal, ose të bëjmë ndonjë të mirë atyre që kanë më së shumti nevojë për ndihmë. Gjithashtu është mirë të kemi parasysh fjalët që meshtari i ka përdorur te gjatë hirit të përhirjes: “Kthehuni e besoni ungjillit” e për këtë kemi nevojë të gjithë.



(Foto: Nue Tuqi)

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: don Anton Uka)

TAKIMI ME KËSHILLIN E MISIONIT

Më 24 shkurt në mbrëmje në Misionin tonë në Luzern ishte takimi me Këshilltarët e Misionit. Në fillim ishte leximi i protokollit të takimit të fundit të Këshilltarëve dhe më pas është vazhduar me pika të ndryshme, të paracaktuara nga misionari don Anton Uka. Kështu që kemi filluar të shqyrtojmë krentrimin e festës së Krishtlindjes, është folur mjaft për përvojën e bekimit të shtëpive, që

edhe pse nuk është shumë e lehtë, për shkak të hapësirës së madhe ku jetojnë dhe punojnë besimtarët tanë, por me ndihmën e përcjellësve dhe me ardhjen e meshtarëve nga Kosova dhe Shqipëria, bekimi i shtëpive këtë vit ishte shumë më i organizuar. Për këtë falënderojmë Zotin dhe ndihmësit, që janë të gatshëm për këtë shërbim që i bëhet Misionit tonë.

Pastaj është vazhduar me temën e Javës së Madhe, si të organizohet sa më mirë. U theksua edhe se organizimi i shtegtimit në Itali dhe në Lurd është duke ecur shumë mirë. Raportin e tyre e kanë dhënë edhe përfaqësuesit e Forumit të Grave, të Korit dhe të Ansambllit Shqiponja. Qëllimi i takimeve dhe punës sonë është që Misioni ynë të jetë sa më funksional dhe në shërbim të të gjithëve. Për këtë falënderojmë Zotin për të gjitha të mirat që na jep përmes Këshilltarëve tanë. Ndërkohë që për këshilltarët lusim Zotin t'i shpërblejë për punën dhe kohën që e dhurojnë për nevojat e Misionit tonë në Luzern.



(Foto: don Anton Uka)



AKTIVITET BAMIRËSIE – PRERJA E FLOKËVE 2024

(Foto: Samuel Rosaj)

Sikurse vitin e kaluar, edhe këtë vit gjatë kohës së Kreshmëve ftohemi të kemi një kujdes të veçantë për të gjithë ata që për arsye të ndryshme personale dhe shoqërore, ndoshta, janë me më pak fat se ne.

Kështu që më 24 shkurt, Misioni ynë, organizoi aktivitetin e bamirësisë me anën e prerjes së flokëve. Kësaj thirrje ju përgjigjen 6 persona që merren me këtë profesion dhe një numër i mirë i besimtarëve tanë që kontribuan për këtë qëllim. Mbrëmjen e filluam me një darkë të përbashkët me ata që u angazhuan në prerjen e



(Foto: Samuel Rosaj)

flokëve. Të gjithë patëm mundësi të qëndrojmë së bashku duke biseduar, luajtur dhe duke u shërbyer me ndonjë pije. Si gjithmonë, fëmijët ju gëzohen më së shumti këtyre takimeve.

Nga ky aktivitet u mbledhen 1152.-CHF dhe 100 euro.

Falënderojmë përzemërsisht Henrik Lushi, Anita Rosaj, Albion Kamberi, Teuta Tetaj, Liridon Tetaj dhe Liridona Gjioden për punën e tyre të bërë me profesionalizëm, si dhe të gjithë ata që erdhën dhe ju përgjigjën kësaj thirrje.



(Foto: Samuel Rosaj)

Shkruan: Redaksia



ECURIA E ANSAMBLIT "SHQIPONJA"

(Foto: Anonim)

Në muajt e fundit, në Ansamblin "Shqiponja" ka pasur shumë aktivitete. Prandaj le të paraqesim një pasqyrë të shkurtër për atë që është arritur dhe përjetuar nga Ansambli.

Gjatë kohës të Krishtlindjes, kemi qenë më aktivë në Misioni duke ndihmuar gjatë festës së Krishtlindjes. Ansambli është i pranishëm

gjithmonë në aktivitetet e shumta të Misionit dhe kontribuon me kënaqësi për të krijuar një atmosferë festive.

Ansambli për të qenë më efikas dhe për ta bërë atë të qëndrueshëm për të ardhmen, statusi është rishikuar dhe përshtatur. Ky i fundit është pritur me pozitivitet nga anëtarët e Ansamblit dhe është pranuar unanimisht. Kjo masë siguron që Ansambli të jetë i strukturuar qartë dhe të vepohet në mënyrë të qëndrueshme.

Me krenari mund të njoftohet se është zgjedhur kryesina për vitin 2024. Denisa Merturi u emërua si kryetare e grupit të valles. Ajo do të mbështetet nga Gjens Frrokaj, i cili merr rolin e zëvendëskryetarit dhe Agnesa Toplanaj si përfaqësuese e Ansamblit. Së bashku, ata formojnë një ekip të fortë drejtues që do të përfaqësojë interesat e Ansamblit të valles në mënyrën më të mirë të mundshme.



(Foto: Anonim)



Një tjetër ngjarje e kënaqshme e muajve të fundit ishte bashkëpunimi me mësuesin e valles Arsim Berisha. Jemi të lumtur të njoftojmë se Arsim Berisha e mbështet grupin e valles duke i dhënë mësim një herë në muaj. Aftësia dhe përvoja e tij e pasur ndihmon paraqitjet e Ansambilit në vallëzim dhe po ashtu ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm. Në këtë moment, dëshirojmë të shprehim falënderimin më të sinqertë për Arsim Berishën, për angazhimin e tij të madh dhe mbështetjen e tij të çmuar.

Një tjetër arritje që ka vlerë të madhe, është blerja e veshjes së Rugovës, pra uniforma jonë, e cila ka arritur gjatë këtyre muajve të fundit e cila është dhuratë nga Misioni ynë në Luzern. Falë donacioneve nga sponsorët e ndrysbëm, si dhe angazhimit të anëtarëve të Ansambilit, është përditësuar gardëroba dhe tani prezantohemi në një pamje të re, uniformë që i bënë paraqitjet tona edhe më tërheqëse.

Ansamblit, gjatë kësaj periudhe, ka pasur rastin të tregojë aftësitë e tija në shumë raste, duke përfshirë paraqitjen në turneun e futbollit të Shoqatës “Shoqëria” “Freundschaft” Sursee, si dhe në manifestimin për pavarësinë e Kosovës, organizuar nga Rrjeti i Bizneseve Shqiptare në Zvicrën Qendrore. Me vallet tona emocionuese, kemi befasuar publikun dhe kemi krijuar një atmosferë të mrekullueshme.

Jemi krenar për atë që është arritur si An-

sambël në muajt e fundit dhe me kënaqësi presim të jemi aty në të ardhmen me një angazhim dhe një pasion edhe më të madh për bashkësinë tonë.

Shkruan: Denisa Merturi, Sursee

ANSAMBLI SHQIPONJA LUZERN



Shijoni vallet shqiptare me Ansamblin tonë dhe pasurojdhni manifestimin tuaj me tradita të bukura!

shqiponja-luzern@gmx.ch

FILLO TË NA NDJEKËSH NË INSTAGRAM DHE TIKTOK



Përkrahje Ansamblin tonë me një donacion dhe na ndihmo të promovojmë pasionin tonë për kulturën shqiptare!



ZÄHLBAR AN

CH24-0077 8155 5749 1200 3
Albaner-Mission
Rodleggstrasse 6
6005 Luzern

ZÄHLUNGSZWECK

Për Ansamblin Shqiptarë



STAFI RADIO MARISË SË KOSOVËS NË MISIONIN TONË

(Foto: Nue Tuqi)

Nga data 1 deri më 4 mars 2024, stafi i Radio Marisë së Kosovës vizitoi Misionin tonë në Luzern për të promovuar punën e tij. Gjatë këtyre ditëve kemi kremtuar Meshët e shenjta në Emmenbrucke, Vetroz dhe Sursse, ku Radio Maria në bashkëpunim me vullnetarin e Misionit Avgustin Ramaj transmetuan drejtpërdrejt këto kremtime. Më tej, be-

simtarët tanë të këtij Misioni kanë ndihmuar financiarisht Radio Maria e Kosovës me 4165 franga, të cilat i falënderojmë nga zemra, duke i kujtuar në lutjet tona.

Të dielën më 3 mars, pas kremtimit të Meshës së Shenjtë në Sursse, Nora Ukaj dhe Linda Krasniqi, të cilat janë pjesë e stafit dhe Vilson Ukaj si vullnetar, dëshmuan për punën e tyre. Kjo është dëshmia e tyre:

Linda – redaktore

“Gjatë kësaj vizite në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern unë personalisht kuptova disa gjëra. Besimtarët e këtij Misioni, të cilët janë edhe dëgjuesit tanë, kishin diçka të veçantë! Duke qenë se shumicën prej tyre i kam takuar fizikisht për herë të parë, më kanë lënë përshytyje të mirë që në takimin e parë dhe këtë e them pikërisht sepse kur dikush shpreh gëzim dhe mirësi të sinqertë të jep një ndjesi shumë të bukur. Ata ishin të tillë, na buzëqeshnin, na përshëndetën me shumë respekt dhe dashuri



(Foto: Nue Tuqi)

dhe ndihma e tyre për Radion ka vlerë të madhe për ne. Unë gjithashtu thashë gjatë dëshmisë time në Sursse se Radio Maria e Kosovës nuk mund të ecë përpara pa dëgjuesit e saj. Me fjalë të tjera, Radio Maria e Kosovës është si një pëllumb i paqes që përhap zërin e krishterë kudo, dhe ky pëllumb ka dy krahë të fortë, të cilët në njërin anë janë dëgjuesit, në anën tjetër janë vullnetarët, donatorët dhe bashkëpunëtorët. Dhe një pëllumb nuk mund të fluturojë pa krahë! Megjithatë, sinqerisht i falënderoj secilin prej tyre për këtë ndjenjë dhe për të gjithë ndihmën e dhënë, secilin prej tyre do ta kujtoj në lutje. Falënderoj edhe Misionin Katolik Shqiptar në Lucern, të drejtuar nga Dom Anton Uka - misionar, për këtë mundësi shumë të bukur dhe me ndikim në kuptimin pozitiv, për shërbimin tonë dhe gjithçka tjetër”.

Nora Ukaj - kryeredaktore

“Falënderime të thella për Misionin Katolik Shqiptar në Lucern, për Misionarin Don Anton Uka së bashku me motrat që shërbeni në këtë Mision, për mikpritjen dhe përkrahjen që na of-



ruat ne si staf i Radio Marisë. Jam e kënaqur që patëm rastin të takojmë dhe të dëshmojmë në Misionin tuaj dhe që ndamë vlerat e besimit dhe të punës në mënyrë të përbashkët. Lutemi për suksesin dhe frymëzimin e vazhdueshëm në misionin tuaj dhe për shëndet e bekim të çdo familje në këtë Misioni.

Faleminderit nga zemra për gjithçka!”

Përgatiti: Redaksia



(Foto: Shtjefen Ukaj)



BEKIMI I FAMILJEVE

(Foto: R. V.)

Në kishën e shenjte katolike përveç Sakramenteve kemi edhe bekime të ndryshme, të cilat nuk janë sakramente, por ndihmojnë në forma të ndryshme në rritjen shpirtërore të besimtarëve. Një ndër këto bekime ku pata kënaqësinë ta zhvilloj në bashkësinë shqiptarë në Luzern ishte, bekimi i familjeve dhe banesave.

Para se të bashkëndajë shkurtimisht disa përshtypje të mia personale, dëshiroj të falënderoj meshtarin përgjegjës të kësaj bashkësie, Don Anton Uka, i cili më dha këtë mundësi. Angazhimi i tij është shumë i madh për të kryer këtë shërbim ndaj besimtarëve që i janë besuar në atë vend. Falënderoj motrat për mirësinë e dashurinë që tregojnë në shërbim të vëllezërve dhe motrave shqiptare që ndodhen në këtë vend. Falënderoj këshilltarin e kishës z. Ndue Laska për shoqërimin që ka bërë gjatë përvojës sime.

Mikpritja e shqiptarit edhe pse në një vend të huaj nuk mungon kurrë. Ishte ndjesi shumë e bukur dhe e veçantë të shikoje gatishmërinë e familjes për t'u lutur së bashku dhe për të kërkuar Bekimin e Zotit. Vlerësimi i këtij bekimi shprehej shumë nga pjesëtarët e familjeve, sepse kishin dëshirë që në kohen kur meshtari të vinte

tek shtëpia të jetë e gjithë familja e bashkuar. Pikërisht ky është edhe qëllimi i bekimit: të lutemi së bashku dhe ta nxisë familjen për të marrë pjesë në Meshën e Shenjtë.

Dëshiroj të theksoj edhe një pjesë tjetër shumë të rëndësishme që është transmetimi i besimit nga prindërit tek fëmijët. Gjatë lutjeve që kemi bërë në familje shikoja se si fëmijët edhe pse në moshë të ndryshme dinin lutjet kryesore në gjuhën shqipe dhe të tjerët më të vegjël kishin mësuar nga prindërit ose gjyshërit të bënin shenjen e kryqit. Kjo me jepte shume gëzim sepse vëreja se, përveç punës së përditshme familjarët kushtonin kohën e tyre të çmuar për të edukuar fëmijët me lutjet themelore të fesë sonë të krishterë.

Do kisha edhe shumë gjëra të tjera për të bashkëndarë në këtë eksperiencë të bukur e të veçantë. Por kam dëshirë të përfundoj këtu me një falënderim të veçantë ndaj Zotit për këtë mundësi. Falënderoj Zotin se kisha mundësi për të përcjellë në familjet tona të mira bekimin e Tij.

Uroj me përzemërsi që bekimi dhe hiri i Zotit të qëndrojë në familjet e shtëpitë tuaja. Zoti ju bekoftë!

Shkruan: Dom Zef Marku, Pukë



DEKORIME TË PASHKËVE

Pranvera po troket në dyer, natyra ka filluar të marrë ngjyra të bukura, e diela e shenjtë e Krishtit po afron dhe kështu po përgatitemi të festojmë së bashku festën e Pashkëve.

Festa e pashkëve është një festë vërtetë pranverore. Gjithçka pritet të marrë jetë dhe të japë jetë. Në dyzet ditët e Kreshmëve, krahas njeveve personale të kryera në forma të ndryshme, të shoqëruara me kufizime ushqimore e jo vetëm, bëhen edhe vepra bamirësie, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në këtë kohë sepse shprehin dashurinë ndaj të varfërve.



(Foto: Gjonita Lleshdedaj)

Forumi i Grave, si grup i pandashëm i Misionit, përpiket në mënyra të ndryshme, jo vetëm të ndihmojë aktivitetet e Misionit, por herë pas here, bashkohet dhe punon për të ndihmuar ata që kanë nevojë për ndihmën.

Për Pashkë këtë vit është vendosur të punohet një dekorim i rrumbullakët prej druri, ku sipas gjasave, ky dekorim tradicional i ka rrënjët në mesjetën e largët.

Kreativiteti ndihmon për të patur një humor të mirë por edhe për të krijuar një atmosferë të gëzueshme, kështu që vlera e këtyre produkteve të punuara me dorë është shumë e çmuar.

Respekt dhe falënderim të veçantë për të gjitha gratë që morën pjesë në këtë mbrëmje. Ishte një grup mjaft i madh që me punë, humor, të qeshura dhe në fund me ushqime të shijshme e bëri këtë mbrëmje vërtetë të veçantë. Faleminderit edhe motrave që gjithmonë dinë të na bashkojnë dhe të na ofrojnë mundësi që të ndihemi mirë.

Gëzuar Pashkët!

Shkruan: Valentina Prenrecaj, Root

TESTOJE NJO

Festa e Pashkëve është a të kalohet pa e kuptuar p testi të shkurtër dëshirojr domethënëse për jetën d

1 Pse, ndryshe nga ajo e Krishtlindjes, ndryshon data e festës së Pashkëve?

- P Sepse ne nuk dihet saktësisht se në cilën datë është ringjallur Jezusi.
- J Sepse kështu ka vendosur Papa.
- R Pashkët nuk kanë një datë fikse sepse ajo është e lidhur me ciklin hënor.

2 Pse veza është kaq e pranishme në festën e Pashkëve?

- B Sepse është ushqyese dhe ekonomike.
- I Është simboli i jetës.
- P Sepse janë të ngjyrosura dhe të shijshme.

3 Pse përdoret qengji si simbol i Pashkëve?

- A Fatkeqësisht origjina e kësaj tradite nuk dihet.
- N Ajo simbolizon mirësinë dhe butësinë e Jezusit.
- M Sepse ishte kafsha më e preferuar e Jezusit.

4 Pas sa ditësh u ringjall Jezusi nga të vdekurit?

- G Bibla thotë pas tri ditësh.
- E Një javë pas kryqëzimit dhe vdekjes së Tij në kryq.
- U Të shtunën e madhe.

5 Cilët libra të Biblës flasin për vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit?

- K Besëlidhja e Vjetër.
- P Isaia profet dhe libri i Psalmeve.
- J Besëlidhja e Re, veçanërisht katër Ungjilltarët.

DHURINË TËNDE MBI PASHKËT

kaq e pasur me simbole dhe rituale sa që ndonjëherë rrezikohet lotësisht kuptimin dhe rëndësinë e saj. Prandaj, përmes këtij më të japim disa informacione të rëndësishme për këtë festë kaq theksore besimin tonë të krishterë.

6 Kush është personi i parë që pa Jezusin e ringjallur?

- P Shën Toma sepse ai dylhoi në ringjalljen e Jezusit.
- A Maria Magdalenë është ajo që e pa dhe dëgjoi për herë të parë Jezusin e ringjallur.
- N Pjetri dhe Gjoni pas mbërritjes së tyre në varrin bosh.

7 Sa ditë pas ringjalljes u ngjiti Jezusi në qiell?

- X Ditën e Rrëshajëve ose 50 ditë pas Ringjalljes.
- V Nuk kemi të dhëna të sakta.
- L Në ditën e të Shëlbuesit ose 40-të ditë pas ringjalljes, Jezusi u ngjiti në qiell.

8 Nga cila gjuhë rrjedh fjala Pashkë?

- L Nga greqishtja dhe arramaishtja.
- J Nga gjuha latine.
- P Nga gjuha shqipe, pikërisht nga dialekti gegë.

9 Pse Pashkët janë festa më e madhe e krishterë?

- T Sepse festa e Pashkëve bie në fillim të pranverës.
- E Sepse pas kreshmëve duhet të ketë një festë.
- J Sepse në këtë ditë u përmbush gjithçka që ishte thënë për Jezusin.

10 Cili është kuptimi i këngës ose i brohoritjes tipike të Pashkëve: Aleluja?

- E Kjo brohoritje do të thotë: Krishti u ringjall më të vërtetë.
- A Është një brohoritje gëzimi që përkthyer në shqip do të thotë: Lavdërojeni Hyjin.
- P Është kënga e engjëjve që e përkthyer në shqip do të thotë: Paqe njerëzve në tokë.

*Përgatiti:
don Anton Uka,
Luzern*



ZOJA E LURDIT – HISTORI DHE POROSI

(Foto: nga arkivi)

Dhe kjo amësi e Marisë në ekonominë e hirit vazhdon pareshtur që prej momentit të miratimit bërë besnikërisht në Lajmërim dhe mbajtur pa ngurrim nën kryq, deri në kurorëzimin e përhershëm të gjithë të zgjedhurve. Në fakt, edhe pas Ngjitjes së saj në qiell nuk e ka ndërprerë këtë funksion shpëtimtar, por, me ndërhyrjen e saj të shumëfishtë, vazhdon t'i fitojë për ne dhuratat që na sigurojnë shpëtimin tonë ta amshuar” (Lumen Gentium 62).

Koncili i II-të i Vatikanit ka reflektuar mbi praninë e vazhdueshme të Marisë në jetën e Kishës, e cila është dëftuar në shumë shfaqje të ndryshme. Amësia e saj në Jezusin, përmes të cilës Ai lind për ne, e shoqëron në çdo moment të jetës së Tij tokësore, ashtu me Amësinë e saj e shoqëron edhe Kishën në shtegtimin e saj në rrjedhën e historisë.

Dhe pikërisht në Magnificat-in e saj në mo-

mentin e takimit me kushërirën e saj Elizabetën, Virgjëra Mari shpall: “që se të gjitha breznitë do të më quajnë të lumtur” (Lk 1, 48). Me këtë profeci Maria shpall se do të jetë e pranishme në rrjedhën e historisë, duke shoqëruar me amësinë e saj kishën Shtegtare mbi tokë. Dhe pikërisht edhe festa e shfaqjes së Zojës në Lurd të Francës, tregon ndër to se Maria përmbush profecinë e saj, mbi praninë e saj të vazhdueshme në historinë e Kishës.

Dhe festa e Zojës së Lurdit të cilën festojmë me datën 11 shkurt, ajo që Zoja Mari shprehu Shën Bernadetes Subirou`s ka edhe një vlerë shpirtërore të madhe edhe për kohën që po jetojmë sot. Mesazhet e Zojës së Lurdit shprehin vlera dhe mesazhe shpirtërore për jetën e besimtarëve në përgjithësi, sidomos për ata që, kohë pas kohe, kthehen për ta vizituar Lurdin.

Mesazhi që Zoja Mari i`a zbulon Shën Bar-

nadetës, se Maria i shpall se është “Virgjëra e Papërlyer” ndodh në datën 25 mars, kjo datë për ne të krishterët është përkujtimi i Lajmërimt së Marisë, ku kryengjelli Gabriel shpall Marisë se do të bëhet Nëna e Shëlbuesit, Jezu Krishtit Zotit tonë. Maria zbulon përmes mesazhit dhënë Shën Bernadetës, se ajo ka qenë qysh në fillim e pamëkat.

Por kjo të qënurit e saj si e “Papërlyera” është fryt se si Ajo ka pranuar të jetë Mbartësja e Hyjit, dhe kjo ka bërë që të jetë e “Papërlyera”. Por amësia e Marisë si e Papërlyera e ka shoqëruar Kishën në shtegtimin e saj gjatë historisë, jo vetëm përmes shfaqjeve por edhe përmes lutjes së Saj. Por mesazhi i Zojës së Lurdit, është edhe një ftesë feje edhe për ne të krishterët, pasi edhe ne në jetën tonë jemi të thirrur të jemi të “papërlyer” prej mëkatit, prej egoizmit, materializmit, prej atyre gjërave që mund të na ndajnë prej dashurisë së Zotit dhe ndaj të tjerëve. Dhe të qenurit e “papërlyer” ndodh ashtu si Maria, kur jemi mbartës të Hyjit, dhe këtë e dëshmojmë me jetën tonë. Prandaj edhe mesazhi që Zoja Mari, shpalli



(Foto: nga arkivi)

Shën Bernadetës është edhe një ftesë, që edhe ne të jemi “mbartës të Hyjit” dhe ta dëshmojmë me ligjin e dashurisë.

Shkruan: Dom Pashk Ndoj, Lezhë



(Foto: don Anton Uka)



VALENTINSTAG: DER TAG DER LIEBENDEN

(Foto: Pixabay)

Der Valentinstag, der jedes Jahr am 14. Februar gefeiert wird, ist eine Gelegenheit für Paare und Liebende auf der ganzen Welt, ihre Zuneigung und Liebe füreinander zu feiern.

Der Valentinstag hat seine Ursprünge in der christlichen Tradition und ist nach dem Heiligen Valentin von Terni benannt, der im 3. Jahrhundert in Rom lebte.

Valentin soll als Priester Liebespaare und auch Soldaten welche unverheiratet bleiben sollten, trotz des Verbots christlich getraut haben und deswegen am 14. Februar 269 hingerichtet worden sein. Der heilige Valentin gilt seitdem als der Schutzpatron der Liebenden und Verlobten.

Der Überlieferung nach war Valentin ein Priester, der im 3. Jahrhundert unter dem nicht christenfreundlichen Kaiser Claudius II. in Rom lebte. Laut der Legende schenkte er den frisch verheirateten Paaren Blumen aus seinem Garten und die Ehen, welche durch ihn geschlossen wurden, sollen immer unter einem guten Stern gestanden haben.

Der 14. Februar wurde als Valentinstag gewählt, um an den Todestag von Valentin zu erinnern, der angeblich am 14. Februar stattfand. Im Laufe der Jahrhunderte wurde der Valentinstag zu einem Fest der romantischen Liebe, und es entstanden Bräuche wie das Austauschen von Liebesbriefen und das Verschenken von Blumen, insbesondere rote Rosen, als Zeichen der Zuneigung.

Heutzutage hat der Valentinstag eine breitere Bedeutung bekommen und wird nicht nur von romantischen Paaren, sondern auch von Freunden, Familienmitgliedern und sogar Kollegen gefeiert. Es ist eine Zeit, um Liebe und Zuneigung auszudrücken, sei es durch Geschenke, persönliche Gesten oder einfach nur durch das Zeigen von Wertschätzung füreinander.

Darüber hinaus hat der Valentinstag in den letzten Jahren eine zunehmende Bedeutung als Tag der Selbstliebe und Selbstfürsorge erlangt. Anstatt darauf zu warten, dass ihnen jemand Liebe zeigt, nutzen immer mehr Menschen diesen Tag, um sich selbst zu verwöhnen, sich

etwas Gutes zu tun und sich an die Bedeutung der Selbstliebe zu erinnern.

Während der Valentinstag seinen Ursprung im christlichen Märtyrertum hat, hat er im Laufe der Zeit seine religiöse Bedeutung verloren und wurde zu einem weltlichen Fest der Liebe und Zuneigung. Heutzutage wird der Valentinstag in vielen Ländern auf der ganzen Welt gefeiert und hat eine Vielzahl von Traditionen und Bräuchen angenommen, die je nach Kultur variieren können.

In einer Welt, die oft von Stress, Hektik und Unsicherheit geprägt ist, bietet der Valentinstag eine willkommene Gelegenheit, um Liebe und Zuneigung zu zelebrieren, sei es in romantischen Beziehungen, Freundschaften oder der Beziehung zu sich selbst. Es erinnert uns daran, dass die Liebe in all ihren Formen eine der stärksten und schönsten Kräfte ist, die uns verbinden und bereichern können.

Shkruan: Bergita Krasniqi, Luzern

Himni i Dashurisë i shën Palit

Po t'i flisja gjuhët e njerëzve e të engjëjve, por
po të mos kisha dashurinë,
do të isha porsì bronzi që kumbon
e porsì cimbali që tingëllon.
Po ta kisha dhuratën e profecisë
e t'i dija të gjitha misteret
e të gjitha dituritë;
po ta kisha edhe fenë e plotë,
me të cilën të mund t'u ndërroja vend maleve,
por po të më mungonte dashuria,
s'do të isha asgjë!
Po ta ndaja lëmshë mbarë pasurinë time
dhe po ta jepja trupin tim të digjej,
por, po të më mungonte dashuria,
nuk do të më vlente asgjë!
Dashuria është zemërgjerë,
është e dhimbshme, dashuria,
nuk ka smirë,
nuk mbahet me të madh,
nuk krenohet
nuk është e panjerëzishme,
nuk kërkon interesin e vet,
nuk hidhërohet,
nuk e mban mend të keqen,
nuk i kënaqet padrejtësisë,
por i gëzohet të vërtetës.
Arsyeton gjithçka,

beson gjithçka,
shpreson gjithçka,
duron gjithçka.
Dashuria nuk mbaron kurrë.
Profecitë mbarojnë,
gjuhët shuhën,
njohuritë marrin fund.
Sepse njohuria jonë është e kufizuar
dhe e kufizuar është profecia jonë.
Por, kur të arrijë përsosmëria,
çka është e kufizuar do të marrë fund.
Kur isha fëmijë
flisja si fëmijë,
mendoja si fëmijë,
arsyetoja si fëmijë.
Kur u bëra njeri i pjekur,
flaka çka i përket fëmijërisë.
Vërtet, tani shikojmë si në pasqyrë e në
mënyrë të errët,
por atëherë do të shohim faqe faqas!
Tani njohuria ime është e kufizuar,
atëherë do të njoh plotësisht,
siç jam i njohur.
Tani, veç, mbetet feja, shpresa e dashuria
– këto të tria – porse më e madhja ndër to
është dashuria.

(1 Kor 13, 1-13)



“Ich gehe nicht zur Beichte,
Um interessante Dinge zu
Spüren oder um zu sehen,
welchen Rat man mir gibt,
sondern weil ich mich der
Macht Gottes anvertrauen darf.
Das genügt mir, das gibt mir Freude
und Frieden.”

Carlo Maria Kardinal Martini

Beichten – wie geht das?

Das “SAKRAMENT DER VERGEBUNG” oder auch “Sakrament der Versöhnung”, wie wir es heute nennen, hat sie im Laufe der Zeit sehr gewandelt. Immer mehr Christen, vor allem junge Menschen, entdecken dieses Sakrament, das lange vergessen war, neu. Und das ist gut so! Denn die Beichte hatten früher sogar oft eine abschreckende Wirkung: Man misste ein Sündenregister aufstellen, sein Gewissen erforschen, schliessen in einem Beichtstuhl niederknien und seine Fehler beichten – ohne auch nur ja einen zu vergessen. Heute dagegen erkennen wir, dass das Sakrament der, Versöhnung vor allem die Möglichkeit bietet, mit einem Priester in einen vertrauensvollen und vom Gebet getragenen Dialog zu treten. Und es ist ein guter Weg, um direkt und persönlich mit Gott zu sprechen. Beichten be-

deutet also, mit all seinen Stärken und Fehlern Gott zu begegnen – so, wie man ist. Und Vergebung zu erlangen.

Warum beichten?

JEDER verspürt von Zeit zu Zeit den Wunsch, über das eigene Leben Bilanz zu ziehen. Jeder von uns kennt Probleme um Privat – und Berufsleben. Da gibt es manch gute, manch weniger gute Entscheidung, Worte, die man irgendwann bereut, und solche, die Früchte getragen haben. Es gibt Gefühle, die einen peinlich berühren, verwirren und einem sogar schaden können. Vielleicht belasten schlimme Taten das Gewissen. Beichten – das bedeutet, sich mithilfe eines Priesters unter den Schutz Gottes zu stellen. Dann spürt man im Herzen die Liebe und die Vergebung des Herrn.

So bereiten Sie sich vor!

DIE VORBEREITUNG ist ausserordentlich wichtig, um sich ganz dem Moment der Beichte widmen zu können. Es ist weder nötig, eine Liste mit seinen Sünden zu erstellen, noch allzu streng nach seinen schlimmen Worten und Taten zu forschen. Es geht darum, offen und aufrichtig wieder zum Wesentlichen des Lebens zu gelangen. Zur Vorbereitung können man auch eine Textstelle des Evangeliums auswählen, die zur mo-

mentanen Lebenssituation passt und über die man mit dem Priester gerne sprechen würde.

Seien Sie Dankbar

WARUM beginnen Sie Ihre Beichte nicht, indem Sie Ihre Dankbarkeit ausdrücken? Sie können Gott für eine bestandene Prüfung danken, für die kleinen Freuden des Alltags oder glückliche Erlebnisse. Wenn Sie Gott für solche Erfahrungen danken, werden Sie sich damit seiner Gegenwart und seines Wirkens in den guten Momenten des Lebens bewusst. Beichten bedeutet auch, seinen Glauben bekennen, Gott ins Zentrum von allem zu stellen. So versichern wir ihm, dass wir "Werkzeuge" seines Handelns sind und nichts ohne sein Wirken geschieht.

"Herr, du weisst alles; du weisst, dass ich dich lieb habe" Joh 21,17

Probleme erkennen

BEI DER BEICHTE geht es nicht darum, einfach seine Sünden aufzuzählen – auch wenn es hilfreich ist, sich jener Taten bewusst zu werden, die einen von Gott entfernt haben. Wichtig ist, all das von Gott zu tragen, was man gerne klären würde. Oft sind das bestimmte Haltungen oder Gefühle, die wir nur zu gut kennen, wie Hochmut, Neid oder Zorn. Vielleicht bedauern wir, dass wir zu einer bestimmten Person keine aufrichtige Beziehung aufbauen könnten. Vielleicht sind wir wegen mancher Wünsche oder Begierden ver-

stört. Beichten bedeutet, vor Gott zu treten und ihn um Heilung und Vergebung zu bitten. Es bedeutet, Gott zu bitten, uns zu läutern, von unserer Trägheit und Skepsis zu befreien. Wir appellieren an seine Liebe – die Liebe, die mitfühlt, uns wieder aufrichtet und vervollkommnet.

Rückkehr Zu Gott

EIN GEBET bilden den Abschluss der Beichte. Bevor der Priester im Namen Gottes die Vergebungsworte spricht, also die Absolution erteilt, liest er vielleicht noch eine passende Stelle aus dem Evangelium und gibt dem Beichtenden einige Ratschläge. Es ist wichtig, dass die Beichte aufrichtig ist. Der Frieden und die Freude, die sich daraus ergeben, sind die Früchte einer ernst gemeinten Rückkehr zu Gott. So macht die Beichte frei und glücklich.

Und jetzt?

ZUR BEICHTE gehört der feste Wille, sich in Zukunft ändern zu wollen. Vor allem wenn die bereuten Fehler schwerwiegend waren. Manchmal gehört auch dazu, sein Leben völlig neu auszurichten. Vergebung schliesst einen Neuanfang mit ein. Dabei wird jeder, der sich vom Bösen lossagen möchte, von der Stärke Gottes getragen.

Muss man oft beichten?

Das hängt von jedem Einzelnen ab. Und von der Last, die auf den eigenen Schultern liegt. Vielen fällt es schwer, zu beichten, und sie tun es entsprechend selten. Anderen wiederum tut die Beichte gut, und sie beichten häufig. Wer ein wahres christliches Leben anstrebt, sollte etwa zweimal pro Jahr beichten.

Darf mir ein Priester indiskrete Fragen stellen?

Wie Gott selbst, begegnet auch ein Pries-



(Foto: R.V.)



(Foto: pixabay)

ter demjenigen mit Güte, der ihm sein Leben anvertrauen möchte. Natürlich kann der Priester auch Fragen stellen, die Ihnen auf dem Weg zur Wahrheit helfen. Er wird dabei aber immer diskret und respektvoll bleiben. Auf sicher private Themen, insbesondere Ihr Eheleben, wird er Sie nur ansprechen, wenn Sie das möchten.

Gibt es Sünden, die schwerer sind als andere?

Ja, natürlich. Diebstahl, Mord und Lügen sind schwere Sünden. Aber es gibt auch andere Sünden, die unsere Beziehung zu Gott, zu den Mitmenschen und zu uns selber trüben. Es liegt an jedem Einzelnen, sein Verhalten ehrlich einzuschätzen und zu erkennen, ob es gut ist. Darum muss unser Gewissen auch gründlich erforscht werden.

Wo kann ich beichten?

In Ihre Pfarrgemeinde oder in einem Gemeindezentrum. Informieren Sie sich über die Sprechzeiten Ihres Pfarrers. An vielen Orten gibt es am Tag vor grossen Festen wie Ostern spezielle Beichtmöglichkeiten. Um das Sakrament der Versöhnung empfangen zu können, muss man allerdings getauft sein. Aber niemand wird Sie daran hindern, einen Priester aufzusuchen, wenn Sie mit ihm sprechen möchten!

Darf ich der Beichte alles sagen?

Ein Priester ist kein Psychotherapeut. Wenn Sie sich also wirklich alles von der Seele reden möchten, ist eine gewisse Zurückhaltung geboten. Mit einem Priester sollten Sie aber dennoch über alles reden können: über Ihren Beruf, Ihr Familienleben, Ihre Ehe. Da er durch das Beichtgeheimnis gebunden ist, darf er nichts von dem, was er erfahren hat, preisgeben.

So funktioniert die Beichte

STELLEN SIE SICH ZU Beginn dem Priester kurz vor. Wenn Ihre letzte Beichte lange zurückliegt, erwähnen sie das bitte auch.

Beginnen Sie Ihre Beichte mit dem Kreuzzeichen. Wenn Ihr Beichtgespräch zu Ende ist, können Sie dieses Gebet sprechen: "Barmherziger Gott, ich habe dich und meine Mitmenschen gesündigt. Ich bin nicht würdig, dein Kind genannt zu werden, aber bei dir finde ich Vergebung. Nimm meine Reue an. Der Heilige Geist gebe mir die Kraft, nach deiner Liebe zu leben und nach dem Vorbild dessen, der für unsere Sünden gestorben ist, dein Sohn Jesus Christus, unser Herr."

Der Priester hebt die Hand und erteilt dann die Absolution: "Gott, der barmherzige Vater, hat durch den Tod und die Auferstehung seines Sohnes die Welt mit sich versöhnt und den Heiligen Geist gesandt zur Vergebung der Sünden. Durch den Dienst der Kirche schenke er dir Verzeihung und Frieden. So spreche ich dich los von deinen Sünden im Namen des Vaters und des Sohnes und des Heiligen Geistes." Sie antworten mit "Amen" und machen das Kreuzzeichen. Der Priester kann am Ende der Beichte eine angemessene Busse zur Wiedergutmachung der Sünden auftragen. Meistens handelt es sich dabei um ein Gebet.

(aus: www.glaubenkompakt.de)



MOTIVIMI

(Foto: pixabay)

Motivimi është shoqëruesi ynë i pandashëm, në të gjitha situatat e këndshme dhe të pakëndshme të jetës. Është fuqia themelore për t'u rritur emocionalisht dhe profesionalisht, është motori i veprimeve tona. Ai është forcë, shtysë, një proces më vetë, që nuk lind nga hiçi, por duhet kërkuar, edukuar, dhe nxitur sistematikisht brenda nesh. Motivimi, nuk mund të nxitet veç me shpërblime dhe me dhurata, pasi do të ishte thjeshtë një formë manipulimi ndaj individit, por është prirje e natyrshme për të kërkuar e për të mposhtur sfidat që sjell jeta, nëpërmjet të cilit kënaqim interesat vetjake dhe ushtrime aftësitë tona. Motivimi mundëson të veprosh për t'u ndjerë mirë me veten dhe tjetrin, jo për të përfituar shpërblime e dekorata.

Mungesa e motivimit, e bën individin të paqëndrueshëm emocionalisht dhe profesiona-

lisht. Shkalla e lartë e motivimit ndikon shumë në qëndrueshmërinë e tij. Sa më i motivuar të jetë individi, aq më i qëndrueshëm dhe më i besueshëm do të jetë.

Mundohuni që gjithmonë të gjeni motivim për të jetuar, punuar pa u lodhur, për të kryer detyrat dhe për të mbajtur denjësisht përgjegjësitë tuaja, gjatë gjithë jetës. Për këdo që takoni gjatë rrugës tuaj në jetë, mundohuni të jeni burim dhe frymëzim motivimi me qëndrimet tuaja, me fjalë dhe me sjellje, me dije e me vepra. Nga pikëpamja humaniste, të motivosh do të thotë të nxitësh burimet e brendshme të njerëzve, sensin e tyre të brendshëm për respekt ndaj vetvetes, për pavarësi, vetërealizim, dhe zotësi.

(Shkëputur nga Libri "Të jesh vetvetja",
i autores m. Francika (Suzana) Lekaj)



(Foto: Pixabay)

TË PUSHTUAR NGA INATI

“**M**ë iku mëndja nga inati dhe nuk dita se çfarë thashë e bëra”, është shprehje të cilën e përdorin njerëz të ndryshëm për të justifikuar veprimet e tyre të dhunshme kundrejt një tjetri, por sidomos me njerëz që i quajnë se i kanë nën vete dhe se ata duhet tu binden dhe ti bëjnë gjërat kur thotë i “nxehuri” dhe si thotë i “nxehuri” që po humbet durimin. Këtë shprehje e dëgjon nga burra kur i pushton inati me gratë e tyre e i dhunojnë, e dëgjon nga prindër kur nxehen me fëmijët e tyre e i dhunojnë fizikisht e emocionalisht, e dëgjon nga mësues kur nxehen me nxënësit që nuk u binden apo edukatorët që i ushqejnë me forcë fëmijët sidomos kur refuzojnë ushqimin, madje edhe kur fëmija e vjell ushqimin ato vazhdojnë ta ushqejnë me një lloj inati që të tremb. Ky inat, që pushton të rriturin aq sa të humbasë kontrollin e vetvetes duke harruar, që është bashkëshort, prind apo mësues dhe edukatorë, por vetëm dëshiron të mposhtë “viktimën” tregon që inteligjenca emocionale e këtyre njerëzve lë shumë për të dëshiruar.

Këta njerëz janë të paaftë për të menaxhuar veten dhe për pasojë akuzojnë tjetrin që e ka fajin pasi “u soll keq”. Këta të rritur që harrojnë deri frikën nga ligji tregojnë më së miri se si njerëzit kur i pushton inati, menjëherë u aktivizohet harresa dhe pësojnë anestezi emocionale ku dhembshuria bëhet e paaftë të influencojë mbi inatin që i ka pushtuar. Këta të rriturit kur i pushton inati harrojnë se kush janë dhe kë kanë përballë, ata i drejton vetëm inati edhe pse mund ti duan shumë personat që dhunojnë. Ata janë të paaftë të menaxhojnë veten që të mos bien në kthetrat e paaftësisë së tyre për të vepruar nëpërmjet empatisë apo dhembshurisë. Këta njerëz nuk arrijnë të qetësojnë veten që të mos dhunojnë njerëzit apo fëmijët që i duan. Kur qetësohen i pushton ndjenja e fajit, por dëmi është bërë dhe për më tepër, nuk dinë të kërkojnë të falur, pasi mendojnë se nuk ishte faji i tyre.

Shkruan: Lira Gjika, Tiranë



“TË GJITHËVE GJITHÇKA JU KAM FALUR” DËSHMIA E M. LJUBICA ŠEKERIJA

(Foto: dnevnik.ba)

Në Zagreb, më 1 janar 2024, në moshën 72 vjeçare të jetës dhe 43 vite të jetës rregulltare, ndërroi jetë m. Ljubica Šekerija, motër e Kongregatës Bijat e Dashurisë Hyjnore. Në kujtim të saj sjellim dëshminë e saj.

Motër Ljubica para fillimit të vitit 1992 ka jetuar në kuvendin e motrave në Travnik, Bosnje dhe Hercegovinë dhe ka punuar në Azilin e pleqëve. Në mes të tetorit të vitit 1993 ushtarët e armatosur të ushtrisë B&H me dhunë kanë hyrë në shtëpinë e famullisë në Travnik, dhe famullitarin e asaj kohe don Vinko Vidakovi, tre punëtorë të Caritasit të famullisë si dhe m. Ljubica e cila në ato momente ishte duke ndihmuar në famulli i morën me dhunë nga shtëpia, i futën në një kamion dhe i burgosën në kamp në fshatin Mehuriçi afër qytetit të Travnikut. Përvojën e hidhur të robërisë m. Ljubica e ka dëshmuar para Atit të Shenjtë Françesko me rastin e vizitës së tij në Sarajevë, më 6 qershor të vitit 2023. Dëshmia e m. Ljubica para Papës në takim me rregulltarët dhe rregulltares në Sarajevë:

“At i Shenjtë, quhem motër Ljubica Šekerija

dhe i takoj Kongregatës Bijat e Dashurisë Hyjnore. Deri në fillim të luftës motrat kanë punuar rreth 50 vite në Azilin shtetëror për persona të moshuar dhe të pafuqishëm në Travnik në Bosnjën Qendrore të arqipeshkëvisë së Vrhbosnjes. Në Azilin e përmendur edhe unë kam punuar pesë vite. Në të ishin të vendosur personat e të gjitha besimeve dhe kombësive, më së shumti mysliman. Në punë të gjithë na kanë respektuar dhe nderuar. Kur shpërthej lufta në Bosnje dhe Hercegovinë, erdhën edhe luftëtarë të huaj prej vendeve të ndryshme arabe dhe prej Lindjes së Mesme

Në festën e shën Terezës së Avilës, më 15 tetor 1993, rreth orës njëmbëdhjetë para dite në shtëpinë e famullisë në Travnik, ku isha duke përgatitur drekën hynë pesë luftëtarë të huaj të armatosur. Më detyruan të shkoj me ta. Më është dashur të ngjitem në një kamion. Vendi ku banonim ne, shumica janë mysliman, dhe duke parë sjelljen e këtyre ushtarëve, qeshën dhe duartrokritën.

Në kamion ishte edhe famullitari që ishte i sëmure dhe tre punëtorë të Caritasit të famul-

lisë. Ata filluan të na poshtërojnë duke folur fjalë të ndyra dhe vulgare e duke na rrahur. Na i lidhën sytë duke përdor rrobat tona dhe nuk kemi ditur ku janë duke na dërguar. Të gjithë së bashku, me sy të lidhur na dërguan në fshatin Muheriçi afër Travnikut, në një hapësirë 2x2 m me dy krevate në kat. Na hoqen lidhësen e syve, na morën të gjitha gjërat që patëm në xhepa. Tek unë gjetën vetëm rruzaren dhe çelësat e shtëpisë. Prej famullitarit Vinko kërkuan ta shkelë rruzaren të hedhur dhe të copëtuar në tokë. Famullitari nuk ka dashur ta bëjë këtë. Duke e mbrehur thikën e kërcënuan se se nëse nuk e shkel rruzaren do ta presin motrën. I thash: “Famullitar, le të më presin, por ju mos e shkelni gjënë tonë të shenjtë!” Pas shumë kërcënimeve, bërthijëve na lanë pak vetëm. I mblodha copëzat e rruzares, me thonj e kam grisur dyshekun dhe brenda tij i kam futur kokrrat e rruzares dhe kam lutur Zotin për forcë.

Pas kthimit të luftëtarëve të huaj, më pyetën a kam fëmijë dhe a i kam prindërit gjallë. I thash se nuk kam fëmijë. Kur panë unazën në gishtin



(Foto: Nue Tuqi)

tim më thanë ta heq. Atëherë një prej luftëtarëve lokal tha: “Hiqe shpejt, ose do ta këpus gishtin!” E morën unazën time rregulltare, që për mua ishte e shenjtë. E kam pasur shumë të vështirë. Atëherë luftëtari i huaj më tha: “Nuk ke baba e nënë. Kurse për mua pushka është nënë, pushka është baba, pushka është grua, pushka është fëmijët dhe pushka është gjithçka!” Një prej luftëtarëve vendas më tërhoqi për qafe dhe më rrahu. Në atë moment famullitari Vinko me zë të ulët na ngushëlloi me fjalë: “Mos u frikësoni, të gjithë ju kam dhënë zgjidhjen, mund të vdesim të qetë!” Ato fjalë të famullitarit për mua dhe të tjerët ishin ngushëllim i madh. Prapë ka vazhduar rrahja. Prej meje kanë kërkuar t’ju dorëzoj kryqin ose një gjë tjetër të shenjtë dhe t’ju tregoi emrin tim. Kam thënë se emrin e pagëzimit e kam Ivka. U sollën rreth meje dhe më thanë: “Jo Ivka por Emishihata!” Tani më urdhëruan të ulem dhe t’i shtrij duart duke komentuar se vetëm djalli i mban duart e bashkuara. Në atë moment kam ndjerë tytën e pushkës në ballin tim. Një prej tyre kërkoi prej meje të pranoj se islami është feja më e fortë duke kërkuar që për këtë të mos i tregojnë askujt, përndryshe do të shkojë koka e do të përfundosh në ferr. Kam menduar se do të më pushkatojnë. Njëri prej tyre më pyeti a ke uri, i thash se po, kam uri dhe ai më dha një dardhë duke më thënë: “Ja shiko, se luftëtarët e huaj nuk përdhunojnë, nuk presin, por për këtë asnjë fjalë, përndryshe do të të shkojë koka dhe do të përfundosh në ferr.” Pas gjitha këtyre më liruan dhe më kanë sjellë në kuvendin e motrave në Travnik, kurse meshtari mbeti në burg. At i Shenjtë unë personalisht jua kam falur të gjithëve të gjithëve gjithçka. Sado që torturuesit ishin të vrazhdë, forca dhe hiri i Zotit ishin në anën time.”

Kjo ishte dëshmia e m. Ljubica, kurse Papa Françesko tha se madhësia e m. M. Ljubica është në gatishmërinë e faljes së saj torturuesve”.

(Përktheu nga kroatishtja m. Vida Ademi)



(Foto: Nue Tuqi)

Të nderuar pjesëmarrës
Ndjehem i nderuar dhe i privilegjuar që në emër të Këshillit organizativ të kësaj mbrëmje kulturore t'ju uroj mirëseardhje në promovimin e librit “2000 vjet Krishterim te Shqiptarët”, që në përvjetorin e 16-të të pavarësisë së Kosovës po bëhet në qendrën e Misionit Katolik Shqiptar në Luzern.

Nëpërmjet këtij takimi që përfshinë përshëndetjen, fjalime, vlerësime, kumtesa, këngë dhe ekspozitë artistike, në thelb duam të realizojmë dy gjëra: të kujtojmë të kaluarën tonë, dhe në të njëjtën kohë të falënderojmë për pasurinë e çmuar kulturore dhe shpirtërore që kemi trashëguar nga paraardhësit tanë.

Libri “2000 vjet Krishterim te Shqiptarët”, siç nënkupton edhe vetë titulli, përmes studimeve të studiuesve shqiptarë dhe ndërkombëtarë, shpa-

los historinë dy mijëvjeçarë të krishterimit ndër shqiptarë, duke sjellë në mendje dhe në zemër thesarin e asaj trashëgimie të çmuar kulturore dhe shpirtërore, që të parët tanë, me një inteligjencë të rrallë dhe me një dashuri të gdhendur në kryq, i kanë dhuruar atdheut tonë në veçanti, dhe Evropës në përgjithësi.

Ndërsa kujtojmë historisë tonë, natyrisht edhe falënderojmë. Falënderojmë Zotin, falënderojmë personalitetet e mëdha të kombit, falënderojmë sakrificën dhe gjakun e martirëve dhe dëshmorëve tanë, falënderojmë ata që e shkruan dhe e vulo-sen historinë tonë me dije dhe me penë. Falënderojmë paraardhësit tanë, që më qëndrimin dhe orientimin e tyre, përgatitën rrugën perëndimore për popullin tonë, ju falënderojmë juve, dashamirës të librit dhe të kulturës shqiptare, që me praninë tuaj në këtë mbrëmje dëshmoni dashurinë për kombin.

Të falënderosh nuk do të thotë thjeshtë vetëm t'i thuash dikujt: faleminderit! Në kuptimin filozofik dhe në atë shpirtëror, të falënderosh do të thotë të shprehësh ndjenjën më të thellë të pranimit dhe të vlerësimit për atë që ka vërtetë vlerë dhe kuptim për ne si individ dhe si shoqëri. Kështu, titulli i librit “2000 vjet Krishterim te Shqiptarët”, u zgjodh me aq urtësi dhe krenari nga botuesit, si për të treguar se ne shqiptarët jemi krenar për faktin që kemi qenë ndër popujt e parë evropian,



(Foto: Nue Tuqi)

të cilët e kanë pranuar krishterimin, dhe se me të gjitha sfidat shekullore dhe tendencat e njëpasnjëshme, të brendshme dhe të jashtme, për të deformuar historinë dhe për të mohuar lashtësinë e gjuhës, të traditës dhe të kulturës sonë iliro-shqiptare, gjithmonë kemi punuar për promovimin e historisë dhe të figurave tona kombëtare. Shpresoj dhe lus Zotin që të vazhdojmë kështu përgjithmonë, sepse duke vepruar kështu do ta çojmë në vend porosinë e rilindësve tanë.

Në këtë prizëm mund të themi se përkujtimi dhe falënderimi shpjegojnë të kaluarën tonë, i japin paqe të tashmes dhe krijon një vizion të qartë për të ardhmen e popullit tonë.

Duke ju falënderuar për ardhjen tuaj, uroj të ndiheni mirë me programin e kësaj mbrëmjeje, i cili ka për qëllim ta motivojë secilin, të frymëzohet nga ky thesar i trashëgimisë sonë të krishterë, e cila i dhuroi kombit tonë shqiptar aq shumë dritë, pikërisht atëherë kur errësira po dalldisej dhe harlisej në trojet iliro-dardano-shqiptare dhe njëkohësisht ta përthellojë edhe më tepër miqësinë e Misionit tonë shqiptar me të gjithë dashamirët e kulturës dhe të trashëgimisë tonë burimore shqiptare. Faleminderit dhe Zoti Ju bekoftë!

Shkruan: Dr. Don Anton Uka, Luzern



Të nderuar dhe të dashur pjesëmarrës!
I vetëdijshëm për vështirësinë e bërjes së një sinteze për një vepër kaq të veçantë që përmbledh kontributin shkencor të studiuesve të albanologjisë, teologjisë dhe historisë në dy mijë vjet të krishterimit të shqiptarët, jam limituar në përcjelljen e të paktën një mesazhi në vlerësimin tim për këtë punë të çmuar, duke shpresuar të zgjoj interesin dhe dëshirën tuaj për të lexuar librin.

Studiuesit e kësaj vepre, me punimet e tyre shkencore, shqiptarë dhe të huaj, të krishterë dhe myslimanë, pajtohen me tezën, se krishte-

rimi është pjesë përbërëse e kulturës shqiptare dhe se pa kontributin e krishterimit nuk do të kishim një histori kaq të lavdishme, me figura kaq madhështore dhe shembullore për kombin shqiptar dhe për botën në përgjithësi. Këtu mund të përmendim Niketë Dardanin, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, Gjon Françesk Albanin apo Papa Klementin e XI-të, Gonxhe Bojaxhiun apo Shën Nënë Terezën etj. Këto figura gjigante, unike dhe universale, siç dihet, kishin gjuhën, gjakun dhe prejardhjen shqiptare dhe në doktrinën e krishterë gjenin ethosin ose habitusin, që formoi mendjen dhe frymëzoi shpirtin e tyre humanist.

Studimet e përmbledhura në këtë vepër, secili në formën dhe në fushën e vet, tregojnë se krishterimi si fe, e jo si ideologji, është themeli mbi të cilën ndërtohet qytetërimi shqiptar.

Ja si shkruan Bardhyl Demiraj: “Shkrimi shqip u pagëzua në vitin 1462 nga kryepeshkopi katolik Pal Engjëlli (Paulus Angelus). Në shekujt që pasuan, kleri ynë i krishterë nga të dy besimet (Gjon Buzuku, Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani etj.) kultivoi gjuhën dhe u kujdes për vazhdimin e ekzistencës së ndërgjegjes kombëtare përmes zhvillimit të liturgjisë dhe letërsisë shqipe dhe krishterimit, duke siguruar merita të mëdha të shqiptarët” (fq. 286).

Studimet që do të gjeni në këtë vepër, po ashtu tregojnë se feja e krishterë, ndryshe nga të gjitha religjionet e tjera, ka depërtuar në botën shqiptare, jo vetëm si lajm i shpëtimit për të gjithë ata që e pranojnë dhe e besojnë Jezusin si Zot të vërtetë dhe si njeri të vërtetë, pra, jo vetëm si besim, por edhe si një kulturë e lartë që ka ditur të integrojë zakonet dhe elementet e kulturave dhe feve para-ekzistuese, dhe kështu ka krijuar një shpirt të lirë dhe human, që ka ditur të mbrojë dhe të promovojë lirinë, prosperitetin dhe dinjitetin njerëzor.

Krishterimi të shqiptarët, theksojnë disa nga studiuesit, megjithëse në disa periudha historike është sulmuar, veçanërisht nga sundimi barbar osman, në pjesët e tij më themelore, veçanërisht në lirinë e besimit dhe të shprehjes, prapëseprapë tradita dhe kultura e krishterimit në ndërg-



(Foto: Nue Tuqi)



(Foto: Nue Tuqi)

jegjen e shqiptarëve ka mbetur e gjallë. Pikërisht për këtë shqiptarët e vërtetë kurrë nuk do të pranojnë të tjetërsohen dhe do t'i kundërshtojnë çdo lloj servilizmi që synon asimilimin e tyre shpirtëror e kulturor.

Vlerësimin tim mbi këtë vepër kaq të rëndësishme për historinë tonë kombëtare dhe për letërsinë tonë në përgjithësi dëshiroj ta përmbylli me fjalët e Prof. Dr. Hasan Mujaj, i cili shkruan: “Siç mund të vihet re edhe nga vepërtaria historike, kulturore, letrare dhe identitare e Pjetër Bogdanit, rrënjët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare janë shumë më të thella, shumë më të forta sesa ato që janë thanë, porse herë-herë diskontinuitive për arsye të pretendimeve të huaja pushtuese dhe antishqiptare. Me gjithë rrethanat e ndërlikuara, në të cilat vepronin, astritët dhe feniksët, studiuesit dhe krijuesit shqiptarë, që nga epoka e Gjergj Kastriotit, nuk qëndronin pasivë. Jo. Ata luftuan kush me penë e kush me armë për Shqipërinë e lirë, për shqiptarët, për shkollën shqipe dhe për gjuhën shqipe. Andaj qenë e mbetën flamurtarë të përhershëm të ruajtjes dhe të kultivimit të identitetit kombëtar”.

Shkruan: Dr. Don Anton Uka, Luzern

Prill 2024

02.04.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

23:00 Shtegtim në Itali

05.04.2024

18:30 Mesha dhe adhurim - e
premtja e I e muajit në Luzern

07.04.2024

11:00 Mesha në Inwil/ Zug

13:30 Mesha në Luzern

18:00 Mesha në Giornico

09.04.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

14.04.2024

13:30 Mesha në Luzern

17:00 Mesha në Willisau

16.04.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

21.04.2024

10:30 Mesha në Goldau

13:30 Mesha në Surse

23.04.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

28.04.2024

11:00 Mesha në Inwil/ ZG

13:30 Mesha në Luzern

17:00 Mesha në Menznau

30.04.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

Maj 2024

03.05.2024

18:30 Mesha dhe adhurim - e
premtja e I e muajit në Luzern

05.05.2024

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Sursee

18:00 Mesha në Giornico TI

07.05.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

08.05.2024

20:00 Nisja për Lurd në Luzern

12.05.2024

13:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Willisau

14.05.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

18.05.2024

15:00 Dita e Nënave në Luzern

19.05.2024

10:30 Mesha në Goldau

13:30 Mesha në Surse

20.05.2024

19:30 Grillfest me Grupet e Misio-
nit në Luzern

21.05.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

24.05.2024

20:00 Takimi me të Fejuarit në Lu-
zern

25.05.2024

06:00 Shtegtim në Einsiedeln
(Mesha në ora 19:00)

26.05.2024

11:00 Mesha në Inwil/ ZG

13:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Menznau

28.05.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

30.05.2024

Korpi dhe Gjaku i Krishtit

09:00 Mesha në Willisau

19:00 Mesha në Luzern

31.05.2024

19:00 Mesha në Luthern Bad

Qershor 2024

01.06.2024

18:00 Mesha në Vetroz

02.06.2024

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Sursee

18:00 Mesha në Giornico TI

04.06.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

07.06.2024

18:00 Mesha dhe adhurimi - e
premtja e I e muajit në Luzern

20:00 Takim me të Fejuarit në Lu-
zern

09.06.2024

13:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Willisau

11.06.2024

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

13.06.202419:30 Mesha – Festa e Shna Ndout
& Apéro në Luzern**14.06.2024**

20:00 Takim me të Fejuarit në Luzern

16.06.2024

10:30 Mesha në Goldau

13:30 Mesha në Sursee

23.06.2024

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Emmenbrücke

18:00 Mesha në Menznau

29.06.2024

11:30 Përmbyllja e aktiviteteve me të gjitha Grupet – Grillfest në Sursee

30.06.2024

13:30 Mesha në Emmenbrücke

SHTEGTIMI – LOURDES 2024

Nisja
8 maj, ora 20:00 nga Luzerni

Kthimi
12 maj, në mëngjes

Kushtet për regjistrim të vlefshëm

- Dokument të vlefshëm udhëtimi
- Pagesa e paraparë për shtegtim


Regjistrimi deri në fund të prillit

Misioni Katolik Shqiptar Luzern
E-Mail: albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch
Tel: 041 250 52 80 / 079 371 68 91

Çmimi gjithëpërfshirës
360 franga për të rritur
320 franga për 7-12 vjeçar
290 franga për 0-6 vjeçar

Pagesa

IBAN-Nr: CH94 0077 8155 5749 1200 4
Albaner -Mission
Rodteggstrasse 6
6005 Luzern



SHTEGTIM NË ITALI – PRILL 2024

San Giovanni Rotondo – Genazzano – Roma – Assisi

Nisja
2 prill, ora 23:00 nga Luzerni

Kthimi
6 prill, në mbremje

Kushtet për regjistrim të vlefshëm

- Dokument të vlefshëm udhëtimi
- Pagesa e paraparë për shtegtim

Regjistrimi deri me 25 shkurt

Misioni Katolik Shqiptar Luzern
E-Mail: albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch
Tel: 041 250 52 80 / 079 371 68 91

Çmimi gjithëpërfshirës
430-franga për person (choma dyshe)
450-franga për person (dhoma teke)

Pagesa

IBAN-Nr: CH94 0077 8155 5749 1200 4
Albaner-Mission, Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern
Text: Shtegtimi Itali



STATISTIKA TË VITIT 2023

Pagëzime: 60**Përgatitje për kurorëzim: 22****Varrime: 1****Bamirësi: 71'247.50 franga****Për aktivitete të Misionit: 46'487.71 franga**

**AZB 6005 Luzern
Post CH AG**
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:
Nr. 2/2024
15. Juni 2024

Erscheint im
Juni 2024

Impressum
Misioni Katolik Shqiptar në Luzern
Katholische Albanische Mission in Luzern

Verlag und Redaktion
Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës
Rodteggstrasse 6
CH-6005 Luzern
Tel: +41 41 250 52 60
Cel: +41 79 371 68 91
E-Mail: ukas_cr@hotmail.com
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch

Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.



Recension

“Në shumë forume kishtarë, por edhe në ato laike, vazhdon të bisedohet, të shkruhet dhe të analizohet rëndësia e njëres prej ngjarjeve më të mëdha dhe më të rëndësishme të shekullit të kaluar – Koncili i II i Vatikanit (1962-2022), i cili për shumë gjëra ka shënuar dhe karakterizuar shekullin e XX. Vlerësimet për këtë ngjarje janë të llojllojshme, e të cilat unë i kam përmbledhur në tri kategori përfshirëse:

Ka të tillë që thonë se ky Koncil e ka ndërruar dukshëm, i ka dhënë disa tipare dalluese dhe orientuese, së pari Kishës katolike, krishterimit, por edhe botës bashkëkohore. Kurse, grupi apo qëndrimi i dytë këtë ngjarje e shohin dhe e vlerësojnë si një ngjarje “kronike” thjeshtë kishtarë, pa ndonjë domethënie më të thellë dhe gjithënjëzore. Grupi i tretë janë “tradicionalistët”, të cilët jo vetëm që mohojnë rëndësinë dhe ndikimin pozitiv dhe konstruktiv të Koncilit të II të Vatikanit në Kishë dhe në botë, por shkojnë aq larg, sa që theksojnë ndikimin e tij negativ në Kishë dhe në botë. Kreu i kësaj rryme pa dyshim ishte ipeshkëvi francez tashmë i ndjeri Marcel Leffevre (1905-1991), i cili madje ka themeluar një lëvizje meshtarake (Shën Piu X), për t’i kundërshtuar Papës, Kishës Katolike sidomos reformave të Koncilit të II të Vatikanit!”

Don Lush Gjergji

Të ndihmojmë Misionin tonë!

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3

Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 | 6005 Luzern